

Naim Frashëri (1846-1900) ishte poet, atdhetar e mendimtar. Naimi është një ndër **përfaqësuesit e romantizmit shqiptar**. Ndër veprat e tij më të njohura janë: “Bagëti e Bujqësi”, “Historia e Skënderbeut”, “Qerbelaja”, “Ëndërrimet”, “Lulet e verës”. **Lulet e verës** u shkruajt më 1890. Është e ndikuar nga Dante dhe Petrarka (**Madonizmi**- bukuria dhe dashuria).

Motivi I- Atdhetar

- a-** Shqetësimi, pakënaqësia për gjendjen
- b-** Shpresa për të ardhmen, besimi
- c-** Përparimi nëpërmjet qytetërimit, bashkimit, fatbardhësisë, diturisë, perëndimit
- d-** Gjuha

Motivi II- Filozofiko-meditativ

- a-** Jo filozof, por mendimtar
- b-** Në pikëpamje është teist, panteist, pankalist (bukuria është kudo), platonik në trajtimin e dashurisë
- c-** Zoti dhe gjithësia (Zoti e krijoi gjithësinë dhe gjendet kudo)
- d-** Qenia njerëzore dhe natyra (shfaqje të brendshme dhe të jashtme)
- e-** Përsiatjet: pse?, jeta, vdekja, dhimbja, dashuria, etj.

Motivi III- Erotik

BUKURIA

- Cikël poetik
- Trajtohen bukuria dhe dashuria
- Poezi lirike (filozofiko-meditative)

Karakteristikat e romantizmit:

- Lidhja me natyrën
- Dashuria është ajo që i jep kuptimin e vërtetë jetës
- Dashuria jetohet me rininë
- Dashuria është një ndjenjë e pastër, fisnike që lind nga bukuria
- Dashuria është një ndjenjë e gëzueshme, që kalon nga vuajtjet
- Dashuria lind virtytin
- Dashuria është një ndjenjë që s'mund të shprehet me fjalë, por vetëm të ndjehet

15.

Vera vate, shkoi,

Bilbili pushoi,

Lulet u thanë:

Dimëri u qas,

Dëbora vjen pas,

Fletëtë ranë;

Gjësendi më s'mbet

Thua përmi dhet,

Shpestë pushuan;

Zemra ime zjen

E ty më s'të gjen,

Pa heq e vuan

KOMENT

Në vargjet e kësaj poezie, ciklin e tij jetësor, Naimi e paralelizon me ciklet natyrore. Ai ka përdorur enumeracioni, për të rradhitur të gjitha ato dukuri, që vijnë si pasojë e plakjes. Vera është një stinë e gjallë dhe plot jetë, të cilën Naimi e paralelizon me vitet e rinisë, koha ku, sipas tij, lulëzon dashuria. Me ikjen e rinisë ikën dhe vera dhe autori ka përdorur dy folje sinonime: 'vate', 'shkoi', për ta përforcuar dhimbjen që përjeton nga humbja e dashurisë.

Së bashku me verën, pushoi edhe bilbili, i cili përfaqëson muzikën dhe tingullin melodioz të dashurisë. Pas bilbilit u thanë edhe lulet. Do të thotë se copëzat më të bukura, ato që i japin aromë dhe ngjyrë rinisë, tashmë janë tharë e kanë ikur, pra s'janë e s'do të jenë më.

Në vijim, ne e dimë fare mirë, se pas verës vjen vjeshta e më pas dimri. Por, për të shprehur humbjen e menjëhershme dhe për ta bërë sa më dramatike, Naimi përjeton një dimër të menjëhershëm, i cili vjen direkt pas verës. Në kontrast me pjesën e parë, ku vera me të gjithë ngrohtësinë, tingujt, aromat dhe ngjyrat e saj veniten, në pjesën tjetër vjen dimri, në të cilin mbizotëron e bardha dhe e zeza (ngjyrat e vdekjes).

Në vargun e fundit të kësaj strofe, autori thotë: “Fletëtë ranë”. Ai ka përdorur ë-në fundore, që i ndryshon theksin fjalës. Nëse do të përdorte standartin, kësaj poezie do t'i prishej melodia dhe muzikaliteti. Nga ana kuptimore, Naimi ka përdorur pikërisht gjethet, si organi më i rëndësishëm për jetën e bimëve, ashtu si zemra për njeriun. Pra, nëse gjethet bien, ne shohim një pemë pa jetë (pavarësisht se ajo do të lulëzojë sërish stinën tjetër). Po ashtu ndodh edhe te njeriu. Edhe pse ai vazhdon të jetë gjallë, zemra e tij nuk mund të marri më frymë prej humbjes të dashurisë.

Në vargjet pasuese, Naimi na bënë të kuptojmë se një jetë pa dashuri është një jetë boshe dhe e shkretë. Sipas tij, nga mungesa e dashurisë asgjë s'të hyn më në sy dhe s'ka kuptim në të gjithë botën njerëzore. Gjithashtu, autori ka përdorur teknikën e hiperonimisë. Nëse më lartë ai shprehej se bilbili pushoi, pra kishte zgjedhur këngëtarin më të mirë ndër zogjtë, tashmë ai e përgjithëson, duke thënë se të gjithë shpendët pushuan, për ta thelluar akoma më tepër vakumin e shpirtit të tij. Pra, lartësohet dashuria dhe tingulli i saj si më i ëmbli dhe stopimi i këtij tingulli i bënë të shurdhër gjithë tingujt e tjerë.

Pas kësaj, autori ka përdorur një metaforë për të shfaqur gjendjen e zemrës së tij. Në zemër jetojnë të gjitha emocionet e njeriut dhe në zemrën e poetit tonë mbizotëron gjithandej ndjenja e dashurisë, e cila është aq e fortë dhe ashtu si zien e flluskon uji, ashtu edhe zemra e përvëluar nga dashuria kërkon të dali nga kraharoni. Dhe përballë kësaj ndjenje të zjarhtë qëndron zbrazëtia, që krijohet nga mungesa e më të bukurës ndjenje dashurisë, që bëhet shkaktare për vuajtjen dhe dhimbjen e madhe të zemrës së poetit romantik.